

VENDIM
Nr.72, datë 9.8.2011

**PËR MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË ASETIT, PËRKATËSISHT NËNSTACIONIN
110/20KV TË “KALIMASHIT” NGA OST SHA TEK SHOQËRIA “CEZ
SHPËRNDARJE” SHA**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20 pika “1” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 pika 3 dhe nenit 11 të rregullores “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin nr.89, datë 13.12.2006, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikës 1.3 të licencës “Për aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.8.2011, pasi shqyrtoi kërkesën për miratimin e transferimit të aseteve nga shoqëria OST sh.a. tek shoqëria “CEZ Shpërndarje” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “OST” sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1.1 dhe 1.2 emri dhe adresa e plotë e të licencuarit (janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe korrekte).

- Neni 7, pika 1.3, germa “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, përshkrimi i të licencuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetin e tij (Ky informacion është dhënë i plotë me të gjitha detajet e kërkuara nga rregullorja.).

- Neni 7, pika 2, 3, 4 dhe 5 (Ky informacion është plotësuar tërësisht.).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin e asetit, përkatësisht nënstacionin 110/20kv të “Kalimashit”, nga “OST” sh.a. tek shoqëria “CEZ Shpërndarje” sh.a.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani